



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 261/6 prot.

Tiranë, më 22.6.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 650, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.6.2023, është njoftuar vendimi nr. 650, datë 27.4.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 650, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Ylli Pjetërnikaj”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurive;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli *** Pjetërnikaj, nr.*** prot., datë **.11.2017², ka referuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli *** Pjetërnikaj”³.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dosjeve të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale.

3. Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] Komisioni krijoi bindjen se nuk ka dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo deklarime të rreme, me qëllim fshehje të të ardhurave të paligjshme të përdorura si burim në investime, dhe as veprime që cenojnë besimin e tij në publik. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i është referuar edhe qëndrimin të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) *S vs Albania*, në paragrafin 96 të të cilit, ndër të tjera citohet: “...gjykata vlerëson se në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.2.2021.

³ Konstatohet se ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej Autoriteteve Verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ të Shtetit, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39, të ligjit nr. 84/2016.

keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit”.

Për pasojë, Komisioni krijoi bindjen se balanca negative prej 2 125 845 lekësh dhe shkaqet që e kanë shkaktuar atë nuk cenojnë qëllimin e ligjit nr. 44/2016, sipas të cilit, nëpërmjet deklarimeve ndër vite dhe në atë Vetting, synohet të evidentohen subjekte që kanë fshehur pasuri apo kanë krijuar pasuri me të ardhura të dyshimta. Si e tillë, kjo balancë nuk mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit Pjetërnikaj, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, si dhe për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, parimin e proporcionalitetit dhe parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt ligjor, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit⁴ [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] Komisioni, në kushtet që nga hetimi i kryer: (i) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (ii) nuk u evidentuan rrethana që cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016⁵ [...].

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka vlerësuar se: i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016⁶ [...].

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të aneksit të Kushtetutës, germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni

⁴ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 44 dhe f. 73, të vendimit.

⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 46 të vendimit.

⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 72 të vendimit.

ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit): [...] *1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë. 2. Transferimin e çështjeve të referuara në katër denoncime nga publiku, sikurse arsyetuar në këtë vendim, pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 650/2023, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu nënshtruar juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni duket se nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.

9. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 650, datë 27.4.2023, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Kontrolli i pasurisë

10. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe

shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11. Po ashtu, Komisioneri Publik mban në konsideratë dhe jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili i shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit. Në bazë të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, arsyetimi i Kolegjit orienton Institucionet e rivlerësimit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Sa më sipër, nga ana e Kolegjit vendosen standardet në bazë të parimeve kushtetuese kur gjykohet çështja prej tij.

12. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës”, dorëzuar në ILDKPKI, datë 30.12.2013, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2013 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

13. Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, z. *** ***, ndër të tjera,⁷ kanë deklaruar pasuritë si vijon:

13.1 (i) *Shtëpi banimi në Bashkinë Tropojë, fshati *** ***, Njësia administrative ***. Sipërfaqe 460 m², 2 kate + papafingo. Ajo është ndërtuar në vitin 1990 nga prindërit, si dhe familjarët e tjerë. Është rikonstruktuar në vitin 2007 dhe së brendshmi në vitin 2014. (ii) Objektet me destinacion stallë për bagëti, të cilat ndodhen në Bashkinë Tropojë, fshati *** ***, Njësia administrative *** , në afërsi të banesës së sipërtreguar. Ato kanë sipërfaqe 140 m² dhe 40 m², të ndërtuara nga prindërit dhe vëllezërit e tjerë në vitin 1990. Sipas vlerës së tregut, në total të gjitha objektet mendoj se kanë vlerën 25.000.000 lekë. Sipas situacionit të punimeve, vlera totale e tyre është 17.953.001 lekë. Pjesa takuese: 25%. Dua të sqaroj se për rikonstruksionin e bërë në vitin 2014 të sipërcituar janë përdorur të ardhura nga ato të deklaruara pranë ILDKPKI në vitin 2013, të akumuluar ndër vite nga anëtarët e familjes, si dhe nga të ardhurat e fermës.*

13.2 *Tokë livadh, me sipërfaqe 1.000 m², fshati *** , Njësia Administrative *** , kontratë me kusht, me shkresë të thjeshtë. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

⁷ Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) Tokë arë, e përfituar sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, me sipërfaqe 24 dynymë e 690 m², Bashkia Tropojë, fshati *** ***, Njësia Administrative ***. Pjesa takuese 30%; (ii) 150 krerë dele, të krijuara që nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin *** ***, Njësia administrative ***. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 50%; (iii) 5 lopë, të krijuara që nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin *** ***, Njësia Administrative ***. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 25%; (iv) Bletë, 56 koshere, të krijuara që nga viti 1990 nga prindërit dhe vëllezërit, të cilat ndodhen në fshatin *** ***, Njësia Administrative ***. Vlera: 5.600 euro. Pjesa takuese: 25%; (v) Gëlqere, 50 m³, e trashëguar, e krijuar në vitin 2004, e cila ndodhet në fshatin *** ***, Njësia Administrative ***. Sipas llogaritjes mendoj që vlera e saj në vitin 2013 ka qenë rreth 3.000.000 lekë. Aktualisht, vlera është rreth 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 25%.

13.3 Automjet tip Pegout 307, me targa: ***, blerë me anë të kontratës së shitjes së automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2012. Çmimi është paguar nga të ardhurat e familjes. Ky automjet përdoret nga vëllai im, shtetasi *** ***. Vlera: 4.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

13.4 Automjet tip Volkswagen, me targë: ***, blerë me anë të kontratës me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.12.2014. Çmimi është paguar nga të ardhurat e familjes të akumuluar ndër vite, siç deklarova më sipër, të përdorura edhe për rikonstruksion, të deklaruara në ILDKPKI, viti 2013. Vlera: 4 000 euro. Pjesa takuese: 100%.

13.5 Personi i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: (i) Apartament me sipërfaqe 112.98 m², me nr. pasurie ***/**+**-**, vol. **, faqe ***, në ***, Tiranë. Ky apartament është blerë me të ardhurat e familjes të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim, Ylli Pjetërnikaj, nga familja, në vitin 2013. Vlera: 44.000 euro. Pjesa takuese 100%⁸; (ii) Mobilimi i apartamentit është bërë me të ardhurat e familjes të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim, Ylli Pjetërnikaj, nga familja në vitin 2013. Vlera 2.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

13.6 Në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, të Deklaratës “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura nga ferma vetëm për vitin 2014 në shumën 1.500.000 lekë, ndërsa personi i lidhur, vëllai i subjektit, nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhura me burim nga ferma.

14. Në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 30.12.2013, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera⁹, ka deklaruar pasuritë si vijon:

14.1 Shtëpi banimi, e trashëguar. Qyteti Tropojë, fshati *** ***, Komuna ***, sip. 660 m², 2 kate + papafingo, ndërtuar në 1990, rikonstruktuar në 2007. Vlera: 25.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

14.2 Tokë livadh, fshati ***, Komuna ***, sip 1.000 m². Vlera: 300 000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

14.3 Makinë tip Peugeot 307. Vlera: 4.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

14.4 Vlerë cash, të krijuara ndër vite nga puna dhe ferma. Vlera: 20.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

15. ILDKPKI, në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit¹⁰, ndër të tjera, ka konstatuar:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat familjare, të cilat, referuar deklaratës së rivlerësimit, kanë shërbyer si burim për asetet e deklaruara, ndër të cilat edhe

⁸ Ky apartament është deklaruar në D-Vett., edhe nga subjekti i rivlerësimit.

⁹ Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në këtë deklaratë, ka deklaruar: (i) Tokë arë e trashëguar, qyteti Tropojë, fshati *** ***, Komuna ***, sip. 24 dynmë e 690 m². Pjesa takuese 30%; (ii) 150 krerë dele, të trashëguara, fshati *** ***, Komuna ***, Krijuar në 1996. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 50%; (iii) Bletë, 50 koshere të trashëguara, fshati *** ***, Komuna ***, Krijuar në 1996. Vlera: 5.600 euro. Pjesa takuese: 25%; (iv) 5 lopë, të trashëguara, fshati *** ***, Komuna ***, Krijuar në 1996. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 25%; (v) Gëlqere, 50 m³, e trashëguar, fshati *** ***, Komuna ***, Krijuar në 2004. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 25%.

¹⁰ Referohuni raportit të ILDKPKI-së me nr. **/** prot., datë **.2.2020.

për ndërtimet në Tropojë, rrjedhimisht, mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurive. Në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2013”, subjekti ka deklaruar edhe gjendje cash 20.000.000 lekë, me zotërim të tij 50%, e krijuar ndër vite nga puna dhe ferma, për të cilat nuk ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

16. Nga analizimi në tërësi i vendimit të Komisionit, akteve të administruara në dosjen e hetimit administrativ, si dhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se në total pasuritë në bashkëpronësi të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 30.12.2013, janë në vlerën 48.800.000 lekë dhe 24.600 euro. Si burim krijimi për pasuritë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit deklarohen: (i) të ardhurat e krijuara ndër vite nga familja e subjektit nga punësimi dhe (ii) të ardhurat nga ferma.

17. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, referuar faktit që deri në vitin 2007 (vit kur deklarohet të jetë bërë rikonstruktion i banesës në Tropojë), subjekti i rivlerësimit, në pjesën më të madhe të kohës, ka qenë i mitur (në vitin 2005 ka mbushur 18 vjeç), ndërkohë që në vitin 2007, kur ka qenë 20 vjeç, provohet se ka qenë në qytetin e Tiranës, duke ndjekur studimet e larta, ka vlerësuar se investimet e kryera para vitit 2007, nuk kanë asnjë vlerë për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit Ylli Pjetërnikaj. Si rezultat, pavarësisht se Komisioni ka hetuar mbi familjen bujqësore/prindërore të subjektit të rivlerësimit gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të objektit, në përfundim të hetimit administrativ, ka kryer analizën financiare nga janari i vitit 2008 deri në datën e emërimit në detyrë (nëntor 2013), kur subjekti ka deklaruar likuiditetin cash në vlerën 20.000.000 lekë¹¹.

18. Në analizën e kryer nga Komisioni për periudhën 2008-2013, nuk janë përfshirë të ardhurat nga ferma, nisur nga fakti se informacioni lidhur me këto të ardhura është bazuar në të dhëna statistikore dhe mbetet e pavërtetuar masa faktike e tyre¹². Si rezultat, nga analiza financiare, Komisioni ka konstatuar se duket se familja e subjektit deri në muajin nëntor 2013 kishte mundësi të kursente vlerën 137.232 lekë¹³ dhe jo vlerën 20.000.000 lekë, që është shuma e kursimeve cash deklaruar nga subjekti.

19. Komisioni ka kryer edhe analizën financiare për periudhën 13.11.2013 - 31.12.2016¹⁴, nga ku duket se ka një balancë negative të vitit 2014 në vlerën 2.125.845 lekë, për të përballuar pasuritë dhe shpenzimet. Kjo pamjaftueshmëri vjen për shkak të moskonsiderimit të pjesës takuese të subjektit në investimin për vitin 2014, në vlerën 2.100.000 lekë, me të ardhura të ligjshme.

20. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, ndër të tjera, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se: (i) në DPDFD-në e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë banesë në fshatin *** ***, Tropojë, ndërsa në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar burimin e krijimit vetëm në lidhje me investimet në vitin 2014; (ii) nuk vërtetohet me të ardhura të ligjshme burimi i krijimit të investimit të kryer në vitin 2014 në shumën 8.565.175 lekë¹⁵ nga likuiditeti cash i

¹¹ Referohuni arsyetimit të Komisionit f.17, prg. 28 i vendimit.

¹² Referohuni arsyetimit të Komisionit f.16, prg. 26.11 i vendimit.

¹³ Referohuni në analizën financiare, f.17 e vendimit të Komisionit.

¹⁴ Referohuni në analizën financiare, në faqen nr. 41 të vendimit të Komisionit.

¹⁵ Kjo shumë i referohet të gjithë vlerës së rikonstruktionit të banesës së ndodhur në fshatin *** ***, Tropojë dhe shpenzimeve të mobilimit në vitin 2014, për të gjithë bashkëpronarët.

deklaruar në shumën 20.000.000 lekë, shumë e cila nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, nuk vërtetohet burimi i investimit të pjesës takuese të subjektit (2.100.000 lekë).

21. Lidhur me sa më sipër, në analizë të parashtrimeve të subjektit, Komisioni ka çmuar se, pavarësisht faktit se dokumentet shkresore të paraqitura gjatë procesit dhe në parashtrime dëshmojnë për përfitim të ardhurash nga shitja e produkteve bujqësore e blegtorale nga ana e familjes Pjetërnikaj, ato nuk vërtetojnë të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për periudhën 2008 – 2013, periudhë kur subjekti nuk ka qenë në detyrë¹⁶.

22. Gjithashtu, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *në lidhje me të ardhurat nga ferma, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e likuiditetit në cash prej 20.000.000 lekësh, deklaruar në DPFĐ të vitit 2013, me pjesë takuese 50%, likuiditeti i përdorur për investimin në pjesën takuese të subjektit prej 2.100.000 lekë, edhe në përfundim të procesit, Komisioni ndodhet në të njëjtat kushte e rrethana, sikurse është gjendur gjatë hetimit administrativ. Por, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni çmoi që në vlerësimin përfundimtar të peshës specifike që ka balanca negative prej 2.125.845 lekë, sipas standardit kushtetues, të parashikuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, të shpjegimit bindshëm të pasurisë, duhet të udhëhiqet edhe nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së KPA-së në disa prej vendimeve të tij*¹⁷.

... likuiditeti i deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2013 me burim të ardhurat nga ferma, është krijuar ndër vite kur subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe as subjekt deklarues ...

... likuiditeti prej 20.000.000 lekësh, deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2013, nuk është deklaruar dhe nuk është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit të rivlerësimit, me përjashtim të një autoveture të blerë në vitin 2014, në vlerën 4.000 euro, dhe investimeve për rikonstruksionin e banesës, ku subjekti është bashkëpronar në ¼ e saj, në vlerën 2.100.000 lekë...

*Komisioni krijoi bindjen se balanca negative prej 2.125.845 lekësh dhe shkaqet që e kanë shkaktuar atë, nuk cenojnë qëllimin e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, nëpërmjet deklaramëve ndër vite dhe në atë Vetting, synohet të evidentohen subjekte që kanë fshehur pasuri apo kanë krijuar pasuri me të ardhura të dyshimta. Si e tillë, kjo balancë nuk mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit Pjetërnikaj, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, si dhe për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*¹⁸[...].

23. Komisioneri Publik, në shqyrtim të vendimit nr. 650, datë 27.4.2023, çmon se subjekti i rivlerësimit në gjendjen që janë aktet, nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës dhe se konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk gjen referencë në dispozitat kushtetuese e ligjore apo në një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit për arsye e trajtuara në vijim në këtë ankim.

24. Fillimisht, lidhur me pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit para fillimit të detyrës, Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje se Kolegji i Posaçëm i Apelit, në drejtim të

¹⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit f.19, prg. 29.4 i vendimit.

¹⁷ Komisioni i referohet vendimit të KPA-së nr. 6, datë 17.3.2022, që i përket subjektit ***. ***, ku KPA shprehet se *kjo dispozitë ligjore obligon organet e rivlerësimit që, në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti, duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme.*

¹⁸ Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 40-44 të vendimit.

interpretimit të dispozitave ligjore të paketës së reformës në drejtësi, lidhur me momentin e krijimit të këtyre pasurive, ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar, e cila ka konfirmuar qëndrimin, sipas së cilit për vlerësimin e pasurisë, ligji nuk kufizon as kohën dhe as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre¹⁹.

25. Komisioneri Publik, nisur nga fakti që një pjesë e pasurive të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur janë krijuar apo rrjedhin nga pasuri të krijuara para fillimit të detyrës, çmton se zbatimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit gjen zbatim duke mbajtur në konsideratë edhe elemente të tjerë, si: vlera e pasurisë; mundësia e verifikimit të ekzistencës së mëparshme në kohë e burimeve dhe të ardhurave për krijimin e pasurisë së deklaruar; forma e posedimit të pasurisë (*cash*/sistem bankar); deklarimi i saktë dhe i plotë; mungesa e dyshimeve për fshehje të pasurisë etj.

26. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit dhe akteve të administruara në dosjen e hetimit administrativ, konstatojmë se, megjithëse Komisioni ka analizuar periudhën 2008-2013, për të vlerësuar mundësinë e familjes së subjektit për të krijuar likuiditetin prej 20.000.000 lekësh, duke mos përfshirë në këtë analizë investimet e kryera para vitit 2008, që nga aktet duket të jenë në një vlerë të konsiderueshme, përsëri ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të kursyer likuiditetet *cash* në vlerën 20.000.000 lekë, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 30.12.2013.

26.1 Referuar të dhënave financiare për periudhën 2008-2013, të analizuar nga Komisioni²⁰ rezulton se të ardhurat në total të realizuara nga familjarët e subjektit gjatë kësaj periudhe janë në vlerën 7.605.517 lekë. Këto të ardhura, të para vetëm në raport me kursimin *cash* të deklaruara në vlerën 20.000.000 lekë,²¹ janë dukshëm në një vlerë disa herë më të ulët se kursimet e deklaruara.

27. Lidhur me të ardhurat nga ferma, që deklarohen si një nga burimet e krijimit për pasuritë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, Komisioneri Publik vlerëson se, në gjendjen që janë aktet, duket se nuk provohet realizimi faktik i këtyre të ardhurave dhe as masa e tyre. Të ardhurat e pretenduara me burim nga ferma mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur kështu i paprovuar burimi i krijimit për kursimet *cash*, në vlerën 20.000.000 lekë, dhe pasuritë e rrjedhura prej këtyre kursimeve.

28. Lidhur me deklarin dhe posedimin e likuiditeteve *cash* në vlerën 20.000.000 lekë, që deklarohen si burim krijimi për pasuritë e krijuara pas fillimit të detyrës, nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton si vijon:

28.1 Në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *vlerë cash të krijuara ndër vite nga puna dhe ferma 20.000.000 lekë, pjesa takuese 50%*, ndërsa në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI në datën 31.3.2016 dhe gjatë hetimit administrativ deklaroi pjesë takuese 25%.

28.2 Në deklaratat periodike për vitet 2013-2016, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë deklaruar ndryshime, si: shtesa, pakësime apo gjendje likuiditeti *cash*, si dhe nuk rezultoi t'i

¹⁹ Referohuni vendimeve të Kolegjit (JR) nr.2/2019; (JR) nr.6/2019; (JR) nr.8/2019; (JR) nr.12/2020.

²⁰ Referohuni në analizën financiare në f.17 të vendimit të Komisionit.

²¹ Referuar deklaratës para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe pasuri të tjera.

ketë deklaruar këto kursime *cash* si burim krijimi për pasuritë në pronësi²². Pavarësisht sa më sipër, në D-Vett., si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi i lidhur me të, nuk rezulton të kenë deklaruar kursime *cash*.

28.3 Lidhur me posedimin e këtyre kursimeve në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 30.12.2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi si kursim *cash* të gjithë shumën 20.000.000 lekë, ndërsa gjatë hetimit administrativ, deklaroi se nga kjo shumë vlera 5.000.000 lekë i ishte dhënë hua shtetasit ***. ***, në mars të vitit 2013 dhe nuk posedohej në momentin e deklarimit. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore nuk rezultoi të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, dhënia dhe as kthimi i kësaj huaje.

28.4 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga ILDKPKI, lidhur me një kredi në shumën 1.000.000 lekë, të marrë në muajin korrik të vitit 2014, në *** Bank, në procesverbalin e datës 31.3.2016, ka deklaruar: [...] *Në korrik të vitit 2014 kam marrë një kredi në vlerën 1.000.000 lekë, në *** Bank, e cila është përdorur për rikonstruksionin e stallave të bagëtive në Tropojë. Kjo kredi është mbyllur në muajin tetor 2014, me të ardhurat e siguruara nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale [...], ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka deklaruar [...] Meqë në vitin 2014 kishim filluar punimet për rikonstruksionin e përgjithshëm të banesës ... ne, vëllezërit, kemi menduar që stallat e bagëtive që ishin të ndërтуara në afërsi të banesës t'i shembnim dhe t'i ndërtonim në një distancë më të largët. Kostoja për ndërtimin e tyre ishte goxha e lartë, afro 4 milionë lekë. Për shkak të planifikimit të mënyrës së përdorimit të parave që familja kishte në dispozicion, shuma e parave që ngelte nga ky planifikim nuk e mbulonte një shpenzim të tillë ... Prandaj kam marrë një kredi personale, siç u sipërcitua, e cila u lëvrua në datën 2.7.2014 ... plani për zhvendosjen e stallave nuk u arrit ... në kushtet kur shuma e kredisë nuk u përdor, ajo është kthyer, duke bërë mbylljen e saj në tetor të vitit 2014 [...].*

28.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me pjesën takuese të likuiditeteve *cash*, pasi në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës deklaroi pjesë takuese 50%, ndërsa gjatë hetimit administrativ deklaroi pjesë takuese 25%; (ii) ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me likuiditetet *cash*, pasi nuk ka deklaruar ndryshime në deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk ka deklaruar kursime *cash* në Deklaratën “Vetting”; (iii) nuk rezultoi të ketë deklaruar në asnjë prej deklaratave të pasurisë huan dhënë shtetasit ***. ***, në mars të vitit 2013, dhe as kthimin e saj në datën ***.4.2016; (iv) ka kryer deklarim kontradiktor lidhur me destinacionin dhe shlyerjen e kredisë së marrë në korrik të vitit 2014, si dhe mbetet e paqartë pse, në kushtet kur subjekti ka deklaruar posedimin e kursimeve *cash* në shumën 20.000.000 lekë, në muajin dhjetor të vitit 2013, vetëm 7 muaj më pas i është dashur të marrë një kredi bankare në shumën 1.000.000 lekë, ndërkohë që nuk ka deklaruar përdorimin/pakësimin e këtyre kursimeve në periudhën dhjetor 2013 - korrik 2014.

28.6 Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe, si rezultat, është e pamundur të arrihet në një

²² Në DV-2016 (dorëzuar pas Deklaratës “Vetting”) personi i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit të ardhurat e dhëna subjektit dhe vëllait të tij nga familja, në vitin 2013.

konkluzion se cilat janë deklaramet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me dinamikën dhe gjendjen e kursimeve *cash*.

29. *Lidhur me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, me burim krijimi kursimet cash të deklaruara në vitin 2013*

29.1 Komisioni, ka arsyetuar se:²³ [...] *likuiditeti prej 20.000.000 lekësh, deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2013 nuk është deklaruar dhe nuk është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit të rivlerësimit, me përjashtim të një autoveture, të blerë në vitin 2014, në vlerën 4.000 euro dhe investimeve për rikonstruksionin e banesës, ku subjekti është bashkëpronar në ¼ e saj, në vlerën 2.100.000 lekë [...].*

29.2 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, bazuar në aktet e administruara në dosje, konstaton se këto kursime *cash* janë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur me të, z. *** ***, si burim krijimi për disa pasuri të krijuara pas fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, më konkretisht:

(i) *Rikonstruksion i shtëpisë së banimit në rrethin Tropojë, fshati *** , në vlerën 2.100.000 lekë*

29.3 Në D-Vett., subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Vlera e rikonstruksionit dhe mobilimit ishte në vlerën 2.100.000 lekë. Për këtë rikonstruksion janë përdorur krahas të ardhurave nga ferma në vitin 2014 edhe pjesa e ngelur nga të ardhurat e deklaruara në vitin 2013 pranë ILDKPI.*

29.4 Në DV-2014, subjekti ka deklaruar: *Rikonstruksion i shtëpisë së banimit në rrethin Tropojë, fshati *** , në vlerën 2.100.000 lekë.* Nuk deklarohet burimi i krijimit.

29.5 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi mënyrën e përdorimit të kursimeve *cash* në shumën 20.000.000 lekë, e cila nuk është deklaruar më as në deklaratat periodike vjetore dhe as në atë “Vetting”, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është shpenzuar ndër të tjera dhe për rikonstruksionin dhe mobilimin e banesës së përbashkët në fshatin *** ***, në Tropojë, në vitin 2014.

29.6 Sa më sipër rezulton se si burim krijimi për rikonstruksionin dhe mobilimin e banesës në vlerën 2.100.000 lekë, në vitin 2014, kanë shërbyer pikërisht kursimet *cash*, të deklaruara në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës. Nëse do të llogarisim dhe pjesën takuese të personit të lidhur, z. *** ***, atëherë vlera e investuar/shpenzuar në vitin 2014 do të llogaritej në shumën rreth 4.200.000 lekë.

(ii) *Automjetin tip Volkswagen, me targë: *** , me vlerë 4.000 euro*

29.7 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Automjet tip Volkswagen, me targë *** , blerë me anë të kontratës me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.12.2014. Çmimi është paguar nga të ardhurat e familjes të akumuluar ndër vite, siç deklarova më sipër, të përdorura edhe për rikonstruksion, të deklaruara në ILDKPKI, viti 2013. Vlera: 4 000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

²³ Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 43 e vendimit.

29.8 Ky automjet është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në DV-2014, por nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit.

29.9 Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë automjet kursimet *cash*, të deklaruara në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës.

(iii) *Apartament me sip. totale 112.98 m², ndodhur në ***, Tiranë, në vlerën 44.000 euro dhe shpenzime mobilimi në vlerën 2.000.000 lekë*

29.10 Në D-Vett., personi i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: (i) *Apartament me sipërfaqe 112.98 m², në ***, Tiranë. Blerë me të ardhurat e familjes, të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim, Ylli Pjetërnikaj, nga familja, në vitin 2013. Vlera: 44.000 euro. Pjesa takuese 100%;* (ii) *Mobilimi i apartamentit është bërë me të ardhurat e familjes të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim, Ylli Pjetërnikaj, nga familja, në vitin 2013. Vlera 2.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%.*

29.11 Në DV-2015, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: [...] *Jam bashkëkredimarrës me vëllain tim në kredinë e marrë në shumën 4.500.000 lekë, në *** Bank. Qëllimi i marrjes së kredisë është për blerje apartamenti nga vëllai im, shlyerjet e kësaj kredie bëhen po nga vëllai [...].*

29.12 Në DV-2016, personi i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Apartament banimi me sip.112,98 m² ndodhur në ***, rruga “*** ***”. Për blerjen e këtij apartamenti është nënshkruar kontrata nr. *** rep. dhe nr.*** kol., datë **.11.2014, sipas së cilës vlera prej 12.372 euro është paguar *cash*, ndërsa pjesa prej 31.628 euro është paguar me anë të kredisë marrë me anë të kontratës nr. *** rep. dhe nr.*** kol., datë **.12.2014. Kredia e marrë është shlyer më datë **.6.2016. Të ardhurat për shlyerjen e kësaj kredie kanë ardhur nga kursimet e dhëna nga familja.*

29.13 Nga aktet në dosje rezulton se me kontratë shitje pasurie të paluajtshme me kusht kreditimi nga banka, personi i lidhur, z. *** ***, ka blerë nga shoqëria “*** ***” sh.p.k. pasurinë *apartament me sip. totale 112.98 m²*. Çmimi i apartamentit është në vlerën 44.000 euro, nga të cilat 8.800 euro do të derdhen në llogarinë e noterës brenda datës 20.11.2014, ndërsa kësti i dytë prej 35.200 euro do të paguhet përmes një kredie bankare.

29.14 Referuar informacionit të përcjellë nga *** Bank, me anë të shkresës nr.***/** prot., datë **.12.2020, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëkredimarrësit dhe vëllai i tij, në cilësinë e kredimarrësit kanë marrë një kredi në shumën 4.500.000 lekë, për blerje shtëpie. Rezulton se shuma 4.500.000 lekë është kredituar në llogarinë e z. *** *** dhe në vijim është kaluar në llogarinë e noterës ***. ***, me përshkrimin: “*kësti II për blerje shtëpie*”. Në vijim, në datën ***.6.2016, është depozituar *cash* në llogarinë e *** *** shuma 4.500.000 lekë, që ka shërbyer për mbylljen e parakohshme të kredisë.

29.15 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e z. *** *** në Deklaratën “Vetting” rezulton se si burim krijimi për apartamentin në vlerën 44.000 euro dhe për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në vlerën 2.000.000 lekë kanë shërbyer të ardhurat që u janë dhënë subjektit dhe personit të lidhur nga familja në vitin 2013, të deklaruara në ILDKPKI, si kursime *cash*.

29.16 Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, neni 3, pika 13, dhe neni 32, pika 4, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor të justifikojë jo vetëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në pronësi të tij, por dhe të atyre në pronësi të personave të lidhur, në rastin konkret të pasurive në pronësi të vëllait të tij, z. *** ***.

29.17 Lidhur me pasurinë *apartament me sip.112,98 m²*, megjithëse nga aktet rezultojnë se ky apartament është i regjistruar në emër të z. *** ***, në pyetësorin nr.1 dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se prej dhjetorit 2014 ka banuar në adresën rrugën “*** ***”, në ***, apartament në pronësi të shtetasit *** ***.

29.18 Gjithashtu, për sa kohë që nga aktet në dosje të hetimit administrativ provohet se subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e bashkëkredimarrësit lidhur me kredinë në shumën 4.500.000 lekë, marrë në *** Bank, ky i fundit ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit lidhur me shlyerjen e parakohshme të kësaj kredie.

29.19 Sa më sipër konstatojmë se kursimet *cash* të deklaruara në vitin 2013 kanë shërbyer si burim krijimi jo vetëm për rikonstruksionin e banesës në Tropojë në vitin 2014, në shumën 2.100.000 lekë, që i korrespondon vetëm pjesës takuese të subjektit²⁴ dhe automjetit të blerë në vitin 2014, në shumën 4.000 euro, por kanë shërbyer si burim krijimi dhe për pagesën e apartamentit në shumën 44.000 euro, të cilin subjekti deklaroi se e përdori prej vitit 2014 dhe për mobilimin e tij, në shumën 2.000.000 lekë²⁵.

30. Komisioneri Publik vlerëson se, lidhur me aplikimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, në funksion të shkaqeve të ankimit, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, në gjendjen që janë aktet, duket se nuk qëndron arsyetimi i Komisionit, pasi në rastin konkret pamjaftueshmëria financiare e konstatuar, referuar dhe elementeve të përmendura më lart në këtë ankim, nuk është në masën/vlerën që të mund të gjejnë zbatim këto parime, të aplikuar deri më tani në jurisprudencën e Kolegjit, gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë.

31. Në përfundim, në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, të administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, dhe gjendjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të tij dhe të personit të lidhur me të, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

III.B. Për vlerësimin e aftësive profesionale

32. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit, bazohet në aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësia organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

²⁵ Referuar deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës kanë shërbyer si burimin edhe për rikonstruksionin e pjesës takuese të vëllait të subjektit, *** ***, të banesës në Tropojë që, referuar pjesëve takuese 25% sipas deklarimeve të subjektit, i korrespondon të jetë në vlerën 2.100.000 lekë.

33. Komisioni, për vlerësimin e këtij kriteri, ka administruar dhe shqyrtuar 23 denoncime të publikut lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës dhe/ose i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit për 7 prej tyre.

34. Për çështjet e referuara në katër denoncime, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit, konkretisht në: (i) denoncimin e shtetasës ***, ***, që lidhet me procedimin penal nr. ***, të vitit 2017; (ii) denoncimin e shtetasit ***, ***, që lidhet me procedimet penale nr. ***/2021, ***/2021, ***/2021; (iii) denoncimin e shtetasit ***, ***, që lidhet me procedimin penal nr. ***/2021; dhe (iv) një denoncim anonim që lidhet me procedimin penal nr. *** të vitit 2016, ku në veprimet e prokurorit u konstatua e njëjta problematikë, pasi subjekti nuk është shprehur me vendim për memoriet dhe kërkesat e palëve sipas parashikimit të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni, për një qëndrim sa më objektiv, vlerësoi transferimin e këtyre çështjeve pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

35. Komisioneri Publik, përpara se të vijojë me trajtimin e çështjeve objekt ankimi dhe për të cilat Kolegji do duhet të shprehet në zbatim të juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të tij, çmon të vendosë paraprakisht në konsideratë jurisprudencën orientuese të Kolegjit, në lidhje me rastet e praktikave të transferuara, për të cilat, ndër të tjera, është shprehur se: *praktikat të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasoja të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016.*²⁶

36. Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se dy nga çështjet e transferuara nga Komisioni, konkretisht që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2016 dhe procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, janë jashtë afatit 5-vjeçar nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, të parashikuar nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016. Në këto rrethana, këto çështje, për shkak të afatit të parashkrimit, përjashtohen nga mundësia që të vlerësohen nga organi kompetent për shkelje disiplinore, si dhe duke i shpëputur nga gjetjet e tjera të rezultuara nga vlerësimi i burimeve të kriterit profesional, i përjashton ato dhe nga vlerësimi në funksion të procesit të rivlerësimit.

37. Kolegji, në jurisprudencën e tij orientuese, ka trajtuar dhe rastet e praktikave të transferuara, për të cilat ka arritur në konkluzionin, se atëherë kur mangësitë e subjekteve të rivlerësimit evidentohet se përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, ato përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht.

38. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbi gjetjet e rezultuara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, për sa në vijim:

²⁶ Referohuni vendimit (JR) nr.2/2020, prg. 32.5, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

39. Denoncim²⁷ nga shtetasja * ***,** e cila ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me afatin e përfundimit të hetimeve dhe mungesën e informacionit në lidhje me ecurinë e kallëzimit, të paraqitur prej saj në vitin 2017.

39.1 Për vlerësimin e këtij denoncimi, Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***, datë **.7.2017, për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.

39.2 Komisioni, pasi ka konstatuar se në dosje gjenden të protokolluara kërkesë e shtetases ***, ***, e datës **.12.2017, protokolluar me nr. ***-**, ku kërkohet informacion për gjendjen e procedimit penal dhe kërkesë e datës **.8.2017, protokolluar me nr. ***, për administrim prove në fashikullin hetimor, si dhe nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë marrë vendim për kërkesat e kallëzueses, si dhe nuk i ka kthyer përgjigje në ndonjë formë tjetër, ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit.

39.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se nuk është vënë në dijeni për ekzistencën e memove të shtetases ***, ***. dhe se gjatë kohës që rezulton të jenë dërguar *email* nga shtetasja ***, ***, fashikulli i procedimit penal është mbajtur dhe administruar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore dhe është e paqartë nëse OPGJ-ja ka marrë dijeni lidhur me to.

39.4 Në përfundim, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë denoncim, Komisioni çmoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ dhe, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në çdo rast, ai duhet të kishte disponuar me vendim sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale²⁹.

40. Denoncime nga av. * ***,** i cili është përfaqësues ligjor i tre personave të proceduar penalisht ***, ***, ***, ***, dhe ***,***, ***. Ai ngre pretendime se nuk ka informacion në lidhje me ecurinë e procedimeve penale, pavarësisht kërkesave të drejtuara prej tij prokurorit të çështjes, subjektit Ylli Pjetërnikaj. Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar informacion³¹ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, në lidhje me kërkesat/ankesat e paraqitura nga denoncuesi dhe si është vendosur në lidhje me to, informacion nga i cili rezultoi se:

40.1 *Në lidhje me shtetasin *** ***,* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë ***.9.2021, për veprën penale të

²⁷ Denoncim nr. *** prot., datë **.1.2018 dhe nr. *** prot., datë **.5.2018.

²⁸ Denoncuesja (kallëzuesja) ka qenë punonjëse pranë Ministrisë së Financave dhe pasi asaj i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, e cila ka vendosur: (i) detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave që ta transferojë paditësen në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtë kategori dhe (ii) detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave, t'i paguajë pagën e këtij pozicioni prej datës **.12.2013 e në vazhdim. Paditësja, nëpërmjet përmbauesit gjyqësor, ka kërkuar ekzekutimin e këtij vendimi gjykate të bërë titull ekzekutiv dhe përmbauesi gjyqësor ka kryer veprimet përmbaimore për ekzekutimin e tij. Meqenëse vendimi nuk është ekzekutuar, përmbauesja ka depozituar kallëzimin penal të sipërpërmendur ndaj Sekretares së Përgjithshme të kësaj Ministrie.

²⁹ Neni 110: “Memoriet dhe kërkesat e palëve”, 1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

³⁰ Shihni denoncimet nr. *** prot., dt. ***.12.2021; nr. *** prot., dt. ***.12.2021; nr. *** prot., dt. ***.1.2022.

³¹ Shkresa nr. prot. ***/** prot., datë ***.1.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë.

parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në lidhje me këtë procedim, avokati *** ***(denoncuesi) ka depozituar në Prokurorinë në fjalë:

(i) Një memo me objekt: “*Kërkoj të informohem në cilësinë e mbrojtësit ligjor të zgjedhur nga shtetasi *** ****...”, regjistruar në Prokurori me nr. *** prot., datë ***.10.2021.

(ii) Një kërkesë ankimore në lidhje me mospërmbushjen e detyrës funksionale nga ana e prokurorit të çështjes Ylli Pjetërnikaj, regjistruar në Prokurori me nr. *** prot., datë ***.11.2021.

(iii) Një ankesë në lidhje me mosveprimin e prokurorit, për të cilën Drejtuesi i Prokurorisë ka kërkuar informacion nga prokurori, regjistruar në prokurori me nr. *** prot., datë ***.1.2022. Mbi fletën e informacionit si më lart drejtuar nga subjekti Drejtuesit të Prokurorisë, ky i fundit ka vendosur shënimin: “*Z. Pjetërnikaj, për mendimin tim, duhet t’i vihen në dispozicion mbrojtësit aktet e kërkuara dhe info mbi procedurën*”.

Nga aktet në dosje të Komisionit nuk rezulton të ketë një vendim në lidhje me kërkesat/memot e parashtruara nga avokati.

40.2 Në lidhje me shtetasin *** ***, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë ***.10.2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në lidhje me këtë procedim, avokati *** ***(denoncuesi) ka depozituar në prokurorinë në fjalë:

(i) Kërkesë të datës ***.11.2021, drejtuar prokurorit Ylli Pjetërnikaj, për t’iu mundësuar dhënia e akteve (ato që nuk përbëjnë sekret hetimor).

(ii) Ankesë drejtuar drejtuesit të Prokurorisë në datën ***.12.2021, në të cilën ka parashtruar se ende nuk ka marrë një përgjigje me vendim në lidhje me kërkesën në fjalë dhe ka kërkuar që të merren masa nga drejtuesi i Prokurorisë.

Nga aktet në dosje të Komisionit nuk rezulton të ketë një vendim në lidhje me kërkesën dhe ankesën e parashtruar nga avokati.

40.3 Në lidhje me shtetasin *** ***, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë ***.8.2021, për veprën penale të parashikuar nga nenet 78/2-22 dhe 278/1 i Kodit Penal. Në lidhje me këtë procedim, avokati *** ***(denoncuesi) ka depozituar në Prokurorinë në fjalë:

(i) Memo, regjistruar në Prokurori me nr. *** prot., datë ***.10.2021, ku në cilësinë e mbrojtësit të këtij shtetasi, kërkon të informohet në lidhje me aktet procedurale të dosjes që i përket procedimit penal të filluar ndaj tij.

(ii) Në datën ***.11.2021, av. *** *** ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë kërkesën për detyrimin e Prokurorisë të informojë atë në cilësinë e mbrojtësit ligjor, në lidhje me aktet procedurale të dosjes.

(iii) Kërkesë,³² regjistruar në Prokurori me nr. *** prot., datë ***.11.2021, ku në cilësinë e mbrojtësit të këtij shtetasi, kërkon të informohet në lidhje me aktet procedurale të dosjes.

³² Prokuroria, me shkresën nr. *** prot., dt. ***.12.2021, i ka kthyer përgjigje, duke e sqaruar se: [...] *Momentet procedurale, në të cilat jepen kopje të akteve të një procedimi penal, janë përcaktuar në mënyrë taksative nga legjislacioni procedural penal, duke pasur në fokus garantimin e respektimit të parimeve themelore të procedimit penal. Kështu, në nenin 34/a/ë të*
Faqe 16 nga 19

(iv) Ankesë, regjistruar në Prokurori me nr. *** prot., datë ***.12.2021, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, për mosveprimin e prokurorit. Me shënim në këtë shkresë, Drejtuesi i Prokurorisë ka kërkuar të informohet në lidhje me këtë kërkesë/ankesë dhe prokurori Ylli Pjetërnikaj ka bërë informacion me shkrim në lidhje me sa është kërkuar³³.

40.4 Sa më sipër, Komisioni, pasi ka konstatuar se duket se për kërkesat³⁴ e parashtruara nga avokati, si më lart, subjekti nuk është shprehur me vendim, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të nenit 110, të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit.

40.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, argumenton mungesën e vendimeve të organit të Prokurorisë mbi memot dhe kërkesat e avokatit mbrojtës, me faktin se av. ***. ***. (denoncuesi) është njohur me to në seanca gjyqësore në fazën e gjykimit.

40.6 Në përfundim, Komisioni lidhur me këtë denoncim ka çmuar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit vlerësohen të pabazuara, pasi, në zbatim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, organi procedues duhet të shprehet me vendim për kërkesat dhe memoriet e palëve, duke arsyetuar mbi shkaqet e pranimit apo refuzimit të tyre.

41. Denoncim nga av. * ***,³⁵ i cili është është mbrojtës ligjor i të pandehurit *** *** ***, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 101/2 i Kodit Penal. Midis të tjerash, denoncuesi ngre pretendime se në procedimin penal nr. ***, regjistruar më datë ***.5.2021, nga ana e prokurorit të çështjes, subjektit Ylli Pjetërnikaj janë kryer shkelje procedurale, pasi subjekti nuk ka dalë me vendim për kërkesat e tij lidhur me ecurinë e hetimeve dhe nuk e ka njohur as me aktet e fashikullit të hetimit të paraqitura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në seancën për dërgimin e çështjes në gjyq.**

41.1 Komisioni, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit, ka administruar³⁶ një kopje të dosjes gjyqësore, që i përket këtij procedimi. Referuar vendimit të Komisionit rezulton se në dosje janë administruar disa kërkesa të avokatit, për të cilat nuk ka vendime të prokurorit në lidhje me to. Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

41.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka argumentuar mungesën e vendimeve të organit të Prokurorisë me faktin se dy kërkesat ishin depozituar në periudhën kur çështja ishte nën hetim nga prokurorja e mëparshme dhe se ajo nuk ishte shprehur lidhur me to dhe, përveç kësaj, ato janë bërë pjesë e fashikullit penal nga Oficeri i Policisë Gjyqësore pas momentit të njoftimit të akuzës dhe njoftimit të përfundimit të hetimeve, vetëm pas bërjes së dorëzimeve nga prokurorja ***. ***.

Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se: "1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë ... ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi...". Parashikimet e këtij kodi janë bërë në nenet 34³², 34/a³², 34/b/1/b³², 279/1³², 327³² të tij. Kështu, në zbatim të nenit 34/b/1/b të K. Pr. P., njohja me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e ndalimit apo arrestimit të tij, bëhet në momentet e para procedurale, nëse personi është i arrestuar apo ndaluar. Ndërsa, në bazë të neneve 34, 34/a, 279/1, 327 të K. Pr. P., personi nën hetim do të njihet me aktet e tjera hetimore në momentin e njoftimit të akuzës, si dhe përfundimit të hetimeve. Është e qartë që nuk jemi në asnjë nga këto momente procedurale [...].

³³ Shkresa datë ***.1.2022, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë.

³⁴ Përveç përgjigjes së Prokurorisë drejtuar av. ***. ***, me shkresën nr. *** prot., dt. ***.12.2021.

³⁵ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë ***.11.2021.

³⁶ Me shkresën nr. ***/** prot., datë ***.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë.

41.3 Komisioni, në përfundim lidhur me këtë denoncim, ka vlerësuar se në zbatim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, organi procedues duhet të shprehet me vendim për kërkesat dhe memoriet e palëve, duke arsyetuar mbi shkaqet e pranimit apo refuzimit të tyre.

42. Denoncim anonim, i depozituar pranë ONM-së³⁷

42.1 Midis të tjerash, në këtë denoncim pretendohet se prokurori Ylli Pjeternikaj ka kryer shkelje flagrante në lidhje me dënimin dhe burgosjen e dy shtetasve ***, ***, dhe ***, ***, të kallëzuar nga kunata e tyre e më pas kallëzimi rezultoi i rremë. Ata u dëmshpërblyen nga shteti për burgim të padrejtë.

42.2 Gjatë hetimit administrativ, me qëllim për të vlerësuar pretendimet e denoncuesit, Komisioni ka administruar dosjen e çështjes së hetuar nga subjekti i rivlerësimit³⁸, nga ku rezultoi se në dosje janë administruar disa kërkesa të avokatit mbrojtës të shtetasit ***, ***, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë: (i) Kërkesë për marrjen e kopjes së akteve të hetimit paraprak në ngarkim të shtetasit të mbrojtur prej tij³⁹; (ii) Kërkesë për marrjen e provave⁴⁰ (të listuara në kërkesë), ku është ngritur dhe pretendimi se nga ana e prokurorit nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Në dosje nuk ka të administruar asnjë përgjigje të Prokurorisë drejtuar avokatit në lidhje me këto kërkesa.

42.3 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në lidhje me konstatimet e mësipërme.

42.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *më datë ***,5.2016, mbrojtësi ***, ***, ka paraqitur kërkesë drejtuar Gjykatës Rrethit Gjyqësor, Tiranë ... Seanca gjyqësore është caktuar më datë ***,5.2016. Në këtë seancë gjyqësore, prokurori ka mbajtur qëndrimin e tij kundërshtues, ndërsa gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në kushtet kur brenda javës nga marrja dijoni për kërkesën për marrje provash (datë ***,5.2021), kjo kërkesë është trajtuar gjyqësisht në prani të palëve, dhe kthimi i përgjigjes nuk është vlerësuar i nevojshëm [...].*

42.5 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se, lidhur me kërkesat e avokatit për kryerje të veprimeve hetimore shtesë dhe për marrje të akteve të fshikullit, sqarimet e subjektit nuk vlerësohen bindëse dhe nuk përlligjin mungesën e vendimmarrjes nga ana e prokurorit në zbatim të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale.

43. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në analizë të gjetjeve në denoncimet e mësipërme, vlerëson se mosveprimi procedural i subjektit të rivlerësimit, në të gjitha çështjet e trajtuara më sipër, duke moszbatuar parashikimet e nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, duket një sjellje e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme nga subjekti i rivlerësimit, e cila çon në mosrespektim të të drejtave të palëve, me pasoja për palët, në kuptim të nenit E të aneksit të Kushtetutës.

44. Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit⁴¹, si dhe vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me shkakun e ankimit të mësipërm, dhe me vlerësimin në tërësi të çështjes, vëren se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit

³⁷ Denoncim anonim i përcjellë Komisionit nga vëzhguesi ndërkombëtar, në rrugë elektronike, me *email*-in e datës ***,4.2022.

³⁸ Vënë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, me shkresën e saj nr. ***/*** prot., dt. ***,4.2022, administruar në Komision me nr. ***/*** prot., datë ***,4.2022.

³⁹ Administruar me nr. ***, datë ***,4.2016.

⁴⁰ Administruar me nr. ***, datë ***,4.2016.

⁴¹ Referohuni vendimit nr.2/2020 të Kolegjit, prg. 32.5.

evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht.

45. Në përfundim të shkaqeve të ankimit të trajtuar më sipër, në zbatim dhe të jurisprudencës së Kolegjit, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe etikës së subjektit të rivlerësimit, vlerësojmë se të metat e konstatuara në shqyrtimin e çështjeve të trajtuara gjatë procesit, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave të çështjes së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

46. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

47. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

48. Bazuar në nenet Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016;

49. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 650, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA